



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport
-XIII- Nr. i prot. 41 Më 31.12.2024
Bt. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC

PLANI VJETOR I PUNËS 2025

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria në përbërje prej katër sektorëve; Kulturë, Rini dhe Sport, mbulon fusha me rëndësi në jetën e përditshme, duke përfshirë aktivitetet e ndryshme: muzikë, shfaqje teatrale, art, aktivitete rinore, sportive dhe ruajtjen e trashëgimisë historike e kulturore.

Përveç buxhetit komunal, prioritet është gjetja e burimeve tjera financiare, duke përfshirë edhe ato qendrore; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar, si dhe thellimin e bashkëpunimit me komunat tjera, OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm.

Prioritetet për vitin 2025:

Trajtimi dhe shfrytëzimi i objekteve dhe institucioneve ekzistuese kulturore e sportive në komunën e Rahovecit. Objektet që ofrohen për këto aktivitete janë:

- Shtëpia e Kulturës në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc, Xërxë, Drenoc, Amfiteatri i festivalit Dejn, Amfiteatri në Gradish
- Biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc dhe Hoçë të Madhe
- Kompleksi Sportive në Rahovec & fushat sportive në Rahovec dhe vendbanime tjera të Komunës.
- Fush e futbollit në Dejinë
- Fusha e Futbollit në Xërxë
- Palestra sportive "Mizahir Isma"

Gjatë muajve të parë të vitit 2025, DKRS-së do përkushtohet maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbyshur planin e punës.

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2025
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-së nga viti paraparak,
- Përgatitja e planit të prokurimit për projekte kapitale.

Sektori i Kulturës:

Puna në kuadër të sektorit të Kulturës në komunën e Rahovecit për vitin 2025, do të bazohet në dokumente sic janë:

1. LIGJI NR. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturor
2. Ligji Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës

Prioritete në sektorin e Kulturës për vitin 2025:

- Nxitiqja e bashkëpunimit rreth aktiviteteve kulturore e rinore.
- Nxitiqja e bashkëpunimit me OJQ-të në nivel komunal e më gjërë,
- Projekte me bashkëfinancim në Kulturë, Rini, Sport
- Riparimi, mirëmbajtja e monumenteve historike
- Funkcionalizimi i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve
- Investime në infrastrukturën kulturore dhe në kënde të lojërave për fëmijë
- Përkrahja dhe frymëzimi i krijimtarisë dhe kreativitetit kulturor,
- Përgatitja e projekteve të trashëgimisë kulturore, kujdesi për objektet në listën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fuqia e atyre që duhet të ruhen, evidentimi dhe përkufizimi i vlerave kulturore e historike i objekteve të trashëgimisë kulturore,
- Përkrahja e trajnimeve për punëtorët e sektorit të Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Bibliotekës,
- Mbështetja e projekteve artistike & kulturore dhe “edukative”
- Mbështetja e ngjarjeve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare: Festivale, panairë artizanale

➤ Aktivitetet kulturore, sportive dhe ngjarjet historike për vitin 2025 DKRS -së

Lloji i aktivitetit Data dhe koha	Aktivitetet e planifikuara
◆ 27 janar 2025 Manifestimi kulturor dhe përkujtimor “Flaka e Janarit”	1.Konkurs letrar për fëmijë dhe të rinj (propozim) 2.Homazhe në Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagavc, Celinë dhe Krushë e Madhe 3.Akademi kulturore e përkujtimeve
◆ Dita e Pavarësisë – 17 Shkurti -2025	1.Homazhe dhe nderime për dëshmorët 2. Gara në futboll të vogël (tradicional) 3. Manifestimi festiv
◆ Epopeja e UÇK-së 5, 6, mars 2025	1.Homazhe dhe nderime
◆ Dita e Shkollës Shqipe (Mësuesit) 7 mars 2025	DKA&DKRS
◆ Dita e gruas 8 mars 2025	DKA dhe OJQ-të
◆ Dita e Poezisë 21 mars 2025	Orë poetike
◆ Dita Ndërkombëtare e të burgosurve politik	Tryezë diskutimi me të burgosur politik

◆ Dita Ndërkombëtare e Monumenteve kulturore 18 prill 2025	Tryezë historike me historianë dhe njohës të trashëgimisë kulturore
◆ Dita ndërkombëtare e librit dhe e të drejtave autoriale 23 prill 2025	Diskutime dhe promovime
◆ Dita Botërore e lirisë së shtypit 3 maj 2025	Debat&Tryezë
◆ Manifestimet kulturore e përkujtimore “Java e Dëshmorëve”5 – 12 maj 2025	Homazhe e nderime për dëshmorët Aktivitete kulturore e sportive
◆ Dita Botërore e muzeve 18 maj 2025	Diskutime dhe vizitë muzeve
◆ Festivalit folklorit “Anadina jehon” 11,12,13 maj 2025	1.Promovimi i vlerave kulturore të rajonit të Rahovecit dhe trevave shqiptare.
◆ Dita e Qendrës së Kulturës “Mensur Zyberaj” 27 maj 2025	1. Shfaqje teatrale për të rinj dhe fëmijë 2. Program artistik&kulturor
◆ Dita Olimpike	Gara sportive dhe argëtuese
◆ Dita Botërore e Fëmijëve 1 qershor 2025	Aktivitete argëtuese e festive
◆ Java e Ukshin Hotit 11-16 maj 2025	Akademi politike
◆ Dita e Çlirimit të Komunës së Rahovecit 14 qershor 2025	1.Aktivitete kulturore e përkujtimore 2.Koncert festiv 3.Gara në futboll të vogël (tradicionall)
◆ 17 qershor 2025 Ditelindja e Ukshin Hotit	Ndarja e Dekoratës “Ukshin Hoti”
◆ Epopeja e Rahovecit 17 – 21 korrik 2025	Homazhe dhe nderime për të rënë
◆ Muaji i mërgimtarëve 15 korrik 15 gusht 2025	Aktivitete kulturore, sportive, argëtuese, takime e tryeza me mërgimtarë
◆ Dita Botërore e Rinisë 12 gusht 2025	Aktivitete me të rinj nga diaspora

◆ Shfaqje teatrale (tëtor)	Bashkëpunim me teatro profesionale
◆ Krosi vjeshtor, lojrat sportive tradicionale	Vrapim dhe gara sportive me nxënës të shkollave të mesme e fillore
◆ Festat e Nëntorit "28 nëntor" 2024	Aktivtete përkujtimore, kulturore
◆ Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" 7 dhjetor 2025	1. Konkursi letrar për çmimin letrar "Sulejman Krasniqi"
◆ Sportisti i vitit 28 dhjetor 2025	Aktivitet solemn

Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi"

Puna në kuadër të bibliotekës për vitin 2025, do të bazohet në dokumente siç është:

1. LIGJ Nr. 04/L-097 për Bibliotekat

Projektet dhe planifikimet vjetore në Bibliotekë do të fokusohen në këto tema:

- Furnizimi me libra i bibliotekës dhe hulumtimi për dhurues të librave
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit
- Anëtarësimi/huazime të reja në Bibliotekë
- Evidentimi i punës përmes kartelave të librit
- Përgatitja e informative, lidhur me ecurinë e lexuesve në bibliotekë
- Ngrija e grupeve të leximit në shkolla
- Java e Bibliotekarisë në Kosovë
- Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi"

- Çmimi letrar "Sulejman Krasniqi"
- Dita Ndërkombëtare e Librit
- Dita Ndërkombëtare e Poezisë
- Aktivitete për fëmijë "Rëndësia e bibliotekës për një të ardhme"
- Fuqizimi i librit përmes vizitave nëpër SHFMU dhe aktivitete të ndryshme
- Organizimi i aktiviteteve edukativo-arsimore me nxënës
- Pjesëmarrja në trajnime/konferenca lidhur me librin, në nivel regional dhe qendror
- Hapja e këndit librar.

Sektori i Rinisë:

Puna në kuadër të sektorit të Rinisë për vitin 2025, do të bazohet në dokumente sic janë:

1. Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë
2. Rregulloria për punën vullnetare
3. Udhëzimi Administrativ për Zgjedhje të të rinjve në Vendimarrje

Prioritete në sektorin e Rinisë për vitin 2025:

- Bashkëpunimi me OJQ-të rinore është një nevojë e domosdoshme për përmirësimin e rolit të rinisë dhe për të arritur rezultate konkrete në fushën e rinisë.
- Përkrahja dhe nxitja e punës vullnetare të të rinjve dhe bashkëpunimi me OJQ-të në Rahovec, të cilët e kanë fokus punën me të rinj.
- Ndërtimi i qendres rinore dhe kulturore në Rahovec
- Krijimin e programeve që kanë qëllim promovimin më të madh në punësimin e të rinjve.
- Gjallërimi i jetës kulturore- artistike si edhe nxitja, promovimi i talenteve të reja dhe inkurajimi i krijuesve të rinj të shkollave të mesme.
- Nxitja e të rinjve nga zonat rurale që të përfshihen në sa më shumë në aktivitete.
- Organizimi i forumeve dhe konferenca me fokus rininë
- Fuqizimi dhe përkrahja e rrjeteve dhe qendrave rinore
- Përfshirja e minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara në aktivitete rinore

- Organizimi i datave të rëndësishme që ndërliqhen me rininë

Shënimi i datave me rëndësi për Rininë:

- Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit,
- Dita Ndërkombëtare e Librit,
- Dita Ndërkombëtare e Lumturisë,
- Dita Ndërkombëtare e Solidaritetit Njerëzor,
- Dita Ndërkombëtare e Aftësive të Rinjëve,
- Dita Ndërkombëtare e Rinisë,
- Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit,
- Dita Ndërkombëtare e Poezisë,
- Dita Ndërkombëtare e Vallëzimit,
- Dita Ndërkombëtare e Vajzave në Shkencë,
- Dita Ndërkombëtare e Lumturisë,
- Dita Ndërkombëtare e Lirisë së Shtypit.

Sektori i Sportit:

Puna në kuadër të sportit për vitin 2025, do të bazohet në dokumente sic është:

1. LIGJI Nr. 05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në ngjarjet sportive
2. LIGJI Nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e Sportit
3. LIGJI Nr. 04/L-075 Për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit NR. 2003/24 për Sport

Projektet dhe planifikimet vjetore në Sport, do të fokusohen në këto tema:

- Promovimi i sportit në mesin e të rinjve, si dhe identifikimi dhe përkrahja e talenteve të rinj
- Forcimin e rolit të mjeteve të informimit në promovimin e idesë për marrjen me sport
- Rregullimi i terreneve sportive
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme
- Masivizimi i Sportit
- Përfshirja e minoriteteve në aktivitetet sportive
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për të rinj
- Sportisti i Vitit "2025"
- Java Olimpike
- Kros Vjeshtor
- Përmirësimi i infrastrukturës sportive, ndërtimi i terreneve sportive dhe mirëmbajtja e këtyre objekteve.

Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme, për fillim të punimeve të tri projekteve për komunën e Rahovecit

1. Ndërtimin e stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, në qytet, sipas standardeve të UEFA-së;
2. Ndërtimin e fushave ndihmëse të futbollit të madh, me standardet e Federatës së Futbollit të Kosovës, në Ratkoc dhe Krushë të Madhe.

Përveç këtyre punëve, do realizohen edhe aktivitete e punë të përditshme, si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve,
- Vizita objekteve sportive,
- Takimi me klube dhe shoqata sportive,
- Vizita objekteve kulturore,
- Takime me rini,
- Takimet e rregullta në kuadër të DKRS-së,
- Raportet javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore,
- Organizimi i aktiviteteve kulturore e sportive,
- Monitorimi i aktiviteteve sportive.

Rahovec, nëntor 2024

